

Gjykata Supreme e Kosovës  
Api.-Kzi. nr. 02/2010  
08 qershor 2012

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Martti Harsia si kryetar i kolegit dhe gjyqtarëve të EULEX-it Horst Proetel dhe Tore Thomassen dhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme Nesrin Lushta dhe Avdi Dinaj si anëtarë të kolegit, të ndihmuar nga zyrtarja ligjore e EULEX-it Tara Khan si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër:

B [REDACTED] K [REDACTED], [REDACTED]  
[REDACTED] shqiptar i Kosovës;

I dënuar më 19 shtator 2007 nga Gjykata e Qarkut në Pejë (Kp. nr. 412/2006), vërtetuar dhe ndryshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës më 12 janar 2010 (Ap.-Kz. nr. 153/2008), për Vrasje në kundërshtim të nenit 30, paragrafëve 2 dhe 3 të Kodit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KP KSAK), Vrasje në tentativë në kundërshtim të nenit 30, paragrafit 2 lidhur me nenin 19 të KP të KSAK, Posedim të paligjshëm të armëve, në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/7, dhe Posedim të paligjshëm të armëve, në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe është dënuar me njëzeteshtatë (27) vjet burgim;

Duke vendosur mbi ankesën e ushtruar nga avokati mbrojtës E [REDACTED] N [REDACTED] më 22 mars 2010 dhe shtojcën e ankesës të ushtruar nga avokati mbrojtës B [REDACTED] K [REDACTED] më 12 shtator 2011;

Pas pranimit të mendimit të Prokurorit të Shtetit të Kosovës, dhe pas mbajtjes së seancës së kolegit më 15 maj 2012 në praninë e të pandehurit B [REDACTED] K [REDACTED] dhe avokatit mbrojtës B [REDACTED] K [REDACTED], dhe më 08 qershor 2012 në praninë e Prokurores Publike Judit

Tatrai, B [REDACTED] K [REDACTED] dhe avokatit mbrojtës M [REDACTED] H [REDACTED] të dyja këto seanca të hapura për publik;

Në përputhje me nenet 392 dhe 430 paragrin (2) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), në seancë të hapur shpall këtë:

### **AKTGJYKIM**

**“Shtojca e ankesës” e ushtruar nga avokati mbrojtës B [REDACTED] K [REDACTED] më 12 shtator 2011 HEDHET POSHTË SI E PAAFATSHME.**

Ankesa e ushtruar nga avokati mbrojtës E [REDACTED] N [REDACTED] më 22 mars 2010 REFUZOHEȚ SI E PABAZUAR.

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, Kp. nr. 412/2006, i datës 19 shtator 2007, dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.-Kz. nr. 153/2008, i datës 12 janar 2010, VËRTETOHEN në tërësi.

### **Arsyetimi**

#### **I. Historia e Procedurës**

1. Prokurori publik lëshoi një Aktvendim mbi Fillimin e Hetimeve kundër B [REDACTED] K [REDACTED] dhe dy të dyshuarve të tjera më 6 prill 2004. Më 8 tetor 2004, gjyqtari i procedurës paraprake në Gjykatën e Qarkut në Pejë lëshoi një urdhër për arrest për B [REDACTED] K [REDACTED]. Megjithatë, ai nuk u gjet dhe nuk u arrestua deri më 24 mars 2006.
  
2. Më 21 shtator 2006 është ngritur aktakuza PP Nr. 185/2004 e cila është me të cilën i pandehuri është akuzuar për Vrasje (pika 1) në kundërshtim të nenit 30, paragrafëve 2 dhe 3 të KP KSAK-së, për vrasjen e Policëve të Kosovës S [REDACTED]

T [REDACTED] dhe I [REDACTED] H [REDACTED]; Vrasje në tentativë (pika 2) në kundërshtim të nenit 30, paragrafit 2 të KP KSAK-së; dhe për vrasjen në tentativë të Politit të Kosovës H [REDACTED] L [REDACTED]; Shkaktim të rezikut të përgjithshëm (pika 3) në kundërshtim të nenit 157, paragrafit 1 të KP KSAK-së; Përdorim të Paautorizuar të armëve (pika 4) në kundërshtim të Rregullores së UNMIK-ut 2001/7, për përdorim të armëve me të shtëna nga pusia e policëve të Kosovës; dhe, Mbajtje në Pronësi të paautorizuar të armëve (pika 5) në kundërshtim të nenit 328 parafëve (1) dhe (3) të KPPK-së për armën e zjarrit Beretta të gjetur te ky person kur është arrestuar. Aktakuza u konfirmua për të gjitha pikat më 15 dhjetor 2007.

3. Shqyrtimi gjyqësor u mbajt prej 15 maj 2007 deri 19 shtator 2007. Trupi gjykues shpalli B [REDACTED] K [REDACTED] fajtor për të gjitha pikat e aktakuzës të përmendura më lart dhe e dënoi atë me burgim afatgjatë me 27 vjet.<sup>1</sup> Gjykata e Qarkut përveç kësaj lëshoi edhe një aktvendim të ndarë me të cilin paraburgimi ndaj B [REDACTED] K [REDACTED] vazhdohet deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë.
4. Më 18 shkurt 2008, avokati mbrojtës E [REDACTED] N [REDACTED] ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në emër të të pandehurit.
5. Më 30 nëntor 2008, B [REDACTED] K [REDACTED] u arratis nga Qendra e Paraburgimit në Dubravë.
6. Më 12 janar 2010, gjersa i pandehuri ishte ende të arrati, Gjykata Supreme mbajti një seancë në mungesë të tij për të vendosur lidhur me ankesën e tij kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata Supreme refuzoi ankesën e të pandehurit dhe vërtetoi pjesërisht aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut. Ndryshimet e bëra janë si në vijim: Pika 3 – Shkaktimi i rezikut të përgjithshëm u absorbua nga Pika 1 – Vrasje; Pika 4 – Përdorim i paautorizuar i armëve u ri-cilësua si “Posedim i paligjshëm i armëve” sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/07. Pjesa e mbetur e

---

<sup>1</sup> Aktgjykimi KP nr. 412/2006 i Gjykatës së Qarkut në Pejë. Shënim: Të gjitha referencat për dokumentet dhe numrat e faqeve në fusnota korrespondonjë me versionet në gjuhën angleze.

aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut u vërtetua, përfshirë dënimin me 27 vjet burgim.

7. Më 22 mars 2010, avokati mbrojtës E. N. ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme në emër të B. K. Më 31 mars 2011, ZPSHK-ja paraqiti përgjigje ndaj ankesës.
8. B. K. u kap përsëri më 17 dhjetor 2010 dhe gjendet në paraburgim që atëherë.
9. Më 21 shtator 2011, avokati mbrojtës B. K. paraqiti një "shtojcë të ankesës" kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme në emër të B. K. ZPSHK-ja paraqiti përgjigje ndaj kësaj shtojce të ankesës më 13 mars 2012.
10. Gjykata Supreme mbajti një seancë më 15 maj 2012 në praninë e të pandehurit dhe avokatit mbrojtës B. K. ZPSHK-ja nuk morri pjesë në seancë. Gjatë kësaj seance, avokati mbrojtës ngriti çështjen se ai ende nuk ishte konsultuar me të mbrojturin e tij para seancës edhe pse ishte i njoftuar për lëndën shtatë muaj para seancës. I pandehuri po ashtu ngriti shqetësimin e tij se avokati mbrojtës nuk ishte përgatitur ta përfaqësojë si duhet atë në atë kohë. Prandaj Kolegji për Ankesa vendosi ta shtyjë seancën deri më 08 qershor 2012 për t'ia bërë të mundur të pandehurit ta përgatisë më mirë lëndën e tij.
11. Më 08 qershor 2012, u mbajt seanca e dytë para Gjykatës Supreme në praninë e B. K., avokati të tij të ri mbrojtës M. H. dhe Prokurores Publike të ZPSHK-së Judit Tatrai.

## II. Argumentet e ngritura në ankesë

12. Ankesa e ushtruar më 22 mars 2010 nga avokati mbrojtës E. N. kundërshton aktgjyimin e shkallës së dytë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të

gjendjes faktike dhe shqiptimit të padrejtë dhe të paligjshëm të dënimit me burgim. Avokati mbrojtës propozon të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së dytë dhe B█████ K█████ të lirohet nga Pika 1, 2 dhe 3, ose përndryshe të anulohet aktgjykimi i shkallës së dytë sa i përket Pika 1, 2 dhe 3 dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së dytë për rigjykim në këto pika. Po ashtu propozohet që gjykata e shkallës së dytë të caktojë shqyrtim me qëllim të marrjes së provave të reja në përputhje me nenet 411(2) dhe 412 të KPK-së.

13. Lidhur me vërtetimin e pasaktë të gjendjes faktike:

- Ankesa pretendon se të shtënat nuk janë shkrepur nga vetura Audi e bardhë – e shfrytëzuar për kryerjen e krimit siç është konstatuar nga policia dhe vërtetuar nga Gjykata, por nga një veturë e paidentifikuar e tipit Mercedes. Ankesa vë theksin në dëshmitë e dëshmitarëve dhe në provat e mjekësisë ligjore lidhur me vjetërsinë e gëzhojave të plumbit të gjetura në Audi – si mbështetje të pretendimeve të saj.
- Ankesa vë në pikëpyetje përshkrinin e veturës Audi, të bërrë nga dëshmitarët dhe në identifikimin e B█████ K█████ si vozitës i kësaj vture, si dhe në besueshmërinë e disa dëshmitarëve.
- Ankesa vë në pikëpyetje vlerën dëshmuese të gjurmëve të gishtërinjve të gjetura në Audi për shkak se nuk është vërtetuar vendi i saktë në veturë prej nga janë marrë këto gjurmë si dhe nuk dihet vjetërsia e tyre. Po ashtu kundërshton përputhjen e gjurmëve të gishtërinjve të të pandehurit.
- Ankesa pohon se as vendi i krimtit as lokacioni ku është gjetur vetura Audi nuk janë siguruar në mënyrë të duhur prandaj edhe janë kontaminuar.
- Ankesa kundërshton edhe vërtetimin e elementeve të nevojshme të veprës penale të përdorimit të paautorizuar të armëve.
- Në fund, ankesa gjithashtu ngre përsëri çështjen e mbrojtjes së të pandehurit me alibi.

14. Lidhur vërtetimin jo të plotë të fakteve, ankesa vë në pah përsëri refuzimin e gjykatës së shkallës së parë për të dëgjuar dëshmitarë të caktuar të propozuar nga mbrojtja.
15. Lidhur me caktimin e burgimit, ankesa konsideron se pasi që nuk është vërtetuar se B█████ K█████ ka kryer veprat penale, nuk ka arsyë për të shqiptuar dënimin.
16. Kryeprokurori i EULEX-it në përgjigjen e tij të dhënë më 31 mars 2011, propozon që ankesa të refuzohet si e pabazë për shkak se shumica e argumenteve në ankesë janë ngritur edhe më herët dhe janë trajtuar në mënyrë të drejtë nga gjykata e shkallës së dytë. Përgjigjja më tej thekson se gjendja faktike është rikonstruktuar në tërsi nga gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve të propozuar nga prokuroria dhe mbrojtja dhe të mbështetura me provat dhe raportet e mjekësisë ligjore.
17. Më 21 shtator 2011, avokati mbrojtës B█████ K█████ ka paraqitur "plotësimin e ankesës" ndaj aktgjykimit të Gjykatës Supreme në emër të B█████ K█████, ku ngre argumente lidhur me përdorimin e provave të papranueshme nga ana e gjykates, parregullsitë gjatë procedurës së apelit ndaj aktgjykimit të shkallës së parë dhe pohimet e pambështetura kundër një gjyqtari ndërkombëtar. ZPSHК-ja ka dhënë përgjigjen e saj ndaj kësaj ankesë të plotësuar më 13 mars 2012.

### **III. Lejueshmëria e ankesës dhe e plotësimit të saj**

18. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i është dorëzuar avokatit mbrojtës N█████ më 10 mars 2010 ndërsa i njëjti ka paraqitur ankesën e vet më 22 mars 2010, brenda afatit të përcaktuar ligjor në bazë të nenit 398, lidhur me nenin 430 të KPPK-së. Për këtë arsyë, ankesa është dorëzuar me kohë dhe e njëjta kundërshton aktgjykimin për shkak të vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gjë e cila paraqet arsyë të lejueshme sipas nenit 402 të KPPK-së.

19. I pandehuri ka qenë në arrati në kohën kur Gjykata Supreme ka nxjerrë aktgjykimin e vet, pasi kishte iku nga qendra e paraburgimit në Dubravë. Nuk dihet nëse është ndjekur procedura e paraparë me nenin 127, par. 4 të KPPK-së, në mënyrë që të ndikohet në dorëzimin e irregullt të aktgjykit tek i pandehuri kur nuk dihet vendndodhja e tij / e saj. Pasi që është kapur përsëri, B [REDACTED] K [REDACTED] i është dorëzuar aktgjyki më 6 janar 2011 derisa ka qenë i burgosur në Qendrën e paraburgimit në Pejë. Për këtë arsy, afati për të parashtuar ankesë ka skaduar më 21 janar 2011.
20. Plotësimi i ankesës është parashtuar nga avokati mbrojtës B [REDACTED] K [REDACTED] më 21 shtator 2011, shumë kohë pasi kishte skaduar afati për ankesa. Kështu, sa i përket ngritjes së ndonjë argumenti të ri apo arsyet e re për ankesë, ky plotësim i ankesës duhet patjetër të refuzohet si paafatshëm. Parasysh mund të merren vetëm disa pjesë të këtij plotësimi të ankesës të cilat kërkojnë sqarimin e argumenteve të ngritura në ankesë. Pas shqyrtimit, Gjykata Supreme konstaton se plotësimi i ankesës përbëhet vetëm nga argumente të reja dhe për këtë arsy duhet të refuzohet në tërësi si i paafatshëm.

#### IV. Gjetjet e gjykatës

##### Vërtetimi i pasaktë i fakteve

21. Lidhur me vërtetimin e fakteve, gjykata thekson se është përgjegjësi e gjykatës së shkallës së parë për të dëgjuar, vlerësuar dhe peshuar provat në gjykim me qëllim të konstatimit të gjetjeve faktike. Kështu, gjykatat e apelit duhet patjetër të kenë një shkallë mirëkuptimi ndaj gjykatës që dëgjon të gjitha provat, dhe është në pozitë më të mirë për të bërë një vlerësim të tillë. Gjetjet faktike të gjykatës së shkallës së parë nuk guxojnë të preken vetëm në qoftë se gjykata e apelit konstaton se nuk ka qenë e mundur të arrihet tek provat apo përfundimet e nxjerra në të cilat është mbështetur me asnjë gjykim të arsyeshëm të faktit.

22. Gjykata po ashtu vëren se secili nga faktet specifike për të cilat thuhet se janë vërtetuar në mënyrë të pasaktë, kanë qenë të ngritur edhe më herët në ankesën e të pandehurit ndaj aktgjykit të Gjykatës së Qarkut, prandaj edhe janë shqyrtuar tashmë një herë si dhe janë shpallur nga gjykata e shkallës së parë. Më tej theksohet se aktgjykit e shkallës së parë dhe të dytë ofrojnë një shqyrtim shterues të provave të paraqitura, që në mënyrë të qartë mbështet të gjitha përfundimet e arritura. Prapëseprapë, në vazhdim do të trajtohet secila nga pikat e ngritura në këtë ankesë.
23. *Vetura Mercedes kundrejt veturës Audi.* Ankesa pretendon që Gjykata e Qarkut ka gabuar në gjetje që e shtëna ka filluar nga vetura e bardhë Audi në vend të veturës ende të paidentifikuar Mercedes. Gjykata e refuzon këtë argument. Siç është shtjelluar në aktgjykin e Gjykatës Supreme Ap.-Kz. Nr. 153/2008, Gjykata e Qarkut ka dëgjuar një fushë të madhe të provave dhe ka ofruar vlerësim të hollësishëm të provave në vërtetimin e gjetjes faktike lidhur me përfshirjen e veturës së bardhë Audi në të shtëna. Gjetja e tyre faktike mbështetet nga raportet e mjekësisë ligjore lidhur me gëzhojat e përdorura të gjetura brenda veturës Audi dhe disa dëshmitarë [I. B.,<sup>2</sup> F. Z.,<sup>3</sup> R. B.,<sup>4</sup> Dëshmitari A,<sup>5</sup> R. S. (Dëshmitari B),<sup>6</sup> N. L.<sup>7</sup>] të cilët të gjithë në mënyrë

<sup>2</sup> I. B. ka deklaruar qartë se rrëth orës 08:00 paradite ai është tejkaluar me shpejtësi nga vetura e bardhë Audi me disa njerëz brenda saj. (Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 15 maj 2007, pp. 6-19.)

<sup>3</sup> F. Z. ka dëgjuar krismat e armëve rrëth orës 07:45 paradite dhe përafërsisht pesë minuta më vonë ai pa Audi 80 ose 90 me ngjyrë të çelët të verdhë me shpejtësi me 3-4 persona brenda, me gomë të shpërthyer të anës së majtë të përparme dhe të dritareve me mjegull. (Prova materiale 8, Deklarata e dëshmitarit dhënë në Policinë e UNMIK-ut e datës 25 nëntor 2003; Prova materiale 9, Deklarata e dëshmitarit dhenë policisë së UNMIK-ut e datës 05 dhjetor 2003; Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 23 maj 2007, fq. 19-21.)

<sup>4</sup> R. B. ishte në traktorin e tij përafërsisht në orën 07:30 paradite kur vetura e bardhë Audi me gomë të majtë shpërthyer tejkaloj me një shpejtësi të madhe dhe e gjërvishti gomën e traktorit të tij. (Prova materiale 10, Deklarata e policisë e datës 26 nëntor 2003; Prova materiale 11, Deklarata e dëshmitarit dhënë policisë së UNMIK-ut e datës 08 janar 2004; Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 23 maj 2007, fq. 24-28.)

<sup>5</sup> Dëshmitari A e pa një veturë të bardhë Audi me dritare të mjegulluara që ka tejkaluar xhipin e zyrtarëve të PK-së të cilin ai e ka vërejtur duke vozitur përreth zonës një javë para se të ndodhë incidenti. (Deklarata e dëshmitarit e datës 29 nëntor 2003, Deklarata e dëshmitarit e datës 04 dhjetor 2003, Deklarata e dëshmitarit e datës 19 dhjetor 2003.)

konsekiente përshkruan veturën e ngjyrës së çelët Audi dhe ofruan karakteristika tjera dalluese<sup>8</sup> të cilat më tutje te vërtetojnë identitetin e veturës si veturë e bardhë e gjetur nga policia.

24. Përshkrimi nga dëshmitari A. K. (i cili përshkroi ngjyrën si hiri e çelët dhe identifikoi veturën si ose Audi ose Mercedes)<sup>9</sup>, J. F. (i cili mendoi se dukej sikurse BMW)<sup>10</sup>, I. B. (i cili e përshkroi veturën si veturë e bardhë e ngjashme me Opel Ascona)<sup>11</sup> dhe V. H. (i cili citoi, Mercedes hiri e çeltë metalike)<sup>12</sup> nuk kanë ngritur dyshim domethënës lidhur me identifikimin e veturës Audi dhe përfshirjes së saj në të shtëna. Pritet që llogaritë e dëshmitarëve mund të ndryshojnë pak sa i përket prodhuesit dhe modelit të veturës e cila ishte duke shkuar në një shpejtësi të madhe ose është parë me shikim të shpejtë. Gjithashtu është e arsyeshme që persona të ndryshëm mund të përshkruajnë ngjyrën e veturës në shprehje pak më ndryshe. Këto mospërputhje në lëndën e tanishme në masë të madhe janë tekaluar nga një numër i përshkrimeve të qëndrueshme dhe vërtetuese të ofruara nga dëshmitarët tjerë dhe faktit që të gjithë dëshmitarët vërtetojnë njëri tjetrin lidhur me ngjyrën e veturës së ishte e bardhë apo aftër të bardhës.

<sup>6</sup> R. S. ka dëgjuar krismat e armës dhe pastaj ka parë veturën e bardhë Audi 80 ose 90 me 3 persona brenda me dritare të mjegulluara që ka kaluar me shpejtësi. (Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 27 qershor 2007, fq. 2-7.)

<sup>7</sup> N. L. e përshkroi veturën e bardhë metalike Audi 80 që e ka kaluar si në garë shpejtësie përafërsisht në orën 07:55 paradite. (Deklarata e dëshmitarit dhënë policisë së UNMIK-ut të datës 17 dhjetor 2003.)

<sup>8</sup> Karakteristikat e këtilla përfshijnë një afishe përgjatë drifores së pasme që lexon "Pa frikë", gomën e shpërthyer dhe dritaret me mjegull.

<sup>9</sup> Përafërsisht një minutë pasi që ka dëgjuar krismat e armëve, A. K. ka parë veturën ngjyrë hiri të çelët Audi ose Mercedes të shpejtoj gjatë rrugës dhe është blokuar dhe dy njerëz me flokë të shkurta kanë dalë prej veturës dhe tentuan që ta kthejnë përsëri në rrugë. (Deklarata e dëshmitarit e dhënë në policinë e UNMIK-ut e datës 25 nëntor 2003; Deklarata e dëshmitarit dhënë policisë së UNMIK-ut e datës 22 dhjetor 2003.)

<sup>10</sup> J. F. ka qenë dëshmitarë kur dy njerëz të armatosur kanë dal jashtë veturës të cilën ai ka menduar që është BMW dhe kanë tentuar që ta shtyjnë atë jashtë baltës. (Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 23 maj 2007, fq. 3-11.)

<sup>11</sup> I. B. e ka përshkruar veturën si "veturë e bardhë e cila më është dukur mua si Opel Askona". (Deklarata e dëshmitarit dhënë NjQHK-së e datës 19 dhjetor 2003.)

<sup>12</sup> Deklarata e dëshmitarit dhënë policisë së UNMIK-ut e datës 24 nëntor 2003; Deklarata e dëshmitarit dhënë policisë ndërkombëtare të UNMIK-ut e datës 27 dhjetor 2003.

25. Kështu, pretendimi në ankesë që ekziston “shans i vogël apo nuk ka shanse që vetura të ishte e përfshirë në vrasje” është tërësisht e pabazuar.
26. Për më tepër, mundësia që do të mund të ekzistonte një veturë e dytë, Mercedes, gjithashtu e përshirë në kryerjen e veprës nuk e ndryshon gjetjet e gjykatës lidhur me praninë dhe pjesëmarrjen e veturës Audi në veprën penale.
27. *Identifikimi i dëshmitarit për B. [REDAKTUE] si vozitës të veturës Audi.* Ankesa vë në dyshim identifikimin e B. [REDAKTUE] si vozitës të veturës Audi, e gjithashtu edhe besueshmërisë së disa dëshmitarëve. Gjykata gjithashtu e refuzon këtë argument për të njëjtën arsy si më lart; Gjykata nuk gjen asnjë gabim imponues në vlerësimin e provave të Gjykatës së Qarkut për këtë pikë dhe është e kënaqur me analizat me shkrim të cilat shpinë në konkluzionin që i pandehuri ishte vozitësi i veturës Audi.
28. Siç është përshkruar në hollësi në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut (në faqet 8-11, 15-18, dhe 32-33) dhe e përsëritur në aktgjykimin e shkallës së dytë (në faqen 17), përshkrimi i vozitësit të veturës Audi si flokëverdhë me flokë të qethura shkurt dhe sy të kaltër siç është vërtetuar nga dëshmitarët A, R. [REDAKTUE], dhe I. [REDAKTUE]. Dëshmitari A dhe R. [REDAKTUE] të dytë e kanë identifikuar B. [REDAKTUE] nga albumi i fotografive.<sup>13</sup> Polici i PK-së, R. [REDAKTUE] B. [REDAKTUE] i kujtohet që ka ndalur B. [REDAKTUE] disa muaj para vozitjes së veturës Audi me ngjyrë të bardhë apo ngjyrë banane e cila ishte e regjistruar në emër të mashkullit serb. Veturën e bardhë Audi të zbuluar nga policia pas të shtënave është e regjistruar në emër të S. [REDAKTUE] F. [REDAKTUE].
29. Lidhur me besueshmërinë e dëshmitarëve, Gjykata vëren përsëri që është gjykata e shkallës së parë e cila i ka gjykuar faktet se kush është në pozitën më të mirë të vlerësoj besueshmërinë e secilit dëshmitar dhe të caktoj peshën e duhur përkatëse të secilës provë. Gjykata është e kënaqur që Gjykata e Qarkut në Pejë më tepër se

<sup>13</sup> Dëshmitari më vonë e tërhoqi mbrapsht identifikimin e tij të pandehurit prej albumit të fotografive, megjithatë Gjykata e Qarkut ofroi arsyetim të plotë se pse deklarata e parë e dëshmitarit e dhënë rë polici të jetë e vërtetë dhe llogaria e saktë e ngjarjes.

në mënyrë të duhur ka ushtruar këtë funksion dhe ka ofruar shpjegim të mjaftueshmërm të vlerësimit të saj të besueshmërisë së secilit dëshmitarë në aktgjykimin e shkallës së parë (në faqet 8-18 dhe 22-29).

30. *Gjurma e gishtërinjve e gjetur në veturën Audi.* Ankesa e vë në dyshim vlerën dëshmuese të gjurmës së gishtërinjve për shkak të moshës së tij të diskutueshme dhe të lokacionit të panjohur për veturën Audi. Ankesa më tutje atakon identifikimin e gjurmës së gishtërinjve të gishtit të mesëm të dorës së djathtë të të pandehurit. Gjykata refuzon këtë argument për arsyet si në vijim.
31. Gjykata e Qarkut vlerësoi si provë dëshminë e drejtëpërdrejtë të ekspertit të gjurmëve të gishtërinjve, N. L., raportin me shkrim të S. I., dhe të fotografive të policisë të bëra në veturën Audi. Mbrojtja e ka përdorur mundësinë e saj përi-pjetje të z. L. gjatë dëshmisë së tij, dhe parashtroj pyetje të veçanta lidhur me moshën e gjurmës të gishtërinjve. Eksperti gjithashtu iu përgjigj në pyetjet e bëra nga përfaqësuesi i palës së dëmtuar, anëtarëve të trupit gjykuar dhe të vetë pandehurit. Provat e dëgjuara tregojnë se vjetërsia dhe ruajtja e një gjumë të gishtit varet nga kushtet atmosferike ndaj të cilave është eksposuar dhe sasisë së djersës dhe lëngjeve tjera trupore të pranishme në gishtin e personit.<sup>14</sup> Prandaj, përderisa vjetërsia e saktë e gjurmës së gishtit nuk ka mundur të vërtetohet, mund të mbështetemi në një periudhë të shkurtë kohore deri në përafërsisht dy javë varësisht nga kushtet e lartpërmendura.<sup>15</sup> Ky fakt, i marrë parasysh së bashku me raportin e ekspertit<sup>16</sup> i cili ka bërë përputhjen e gjurmës së gishtin nga vetura Audi me gishtin e mesëm të dorës së djathtë të të pandehurit përbënë provë të mjaftueshme mbi të cilën trupi gjykuar mund të përfundoj se i pandehuri ka pasur kontakt me veturën Audi në një kohë të caktuar brenda një periudhe të shkurtër para zbulimit të veturës së braktisur.

<sup>14</sup> Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 22 maj 2007, f. 8-9, 17.

<sup>15</sup> Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 22 maj 2007, f. 8 & 17.

<sup>16</sup> Mendimi i ekspertit të gjurmëve të gishtërinjve, AFIS file #03-255-CAF, 30 nëntor 2003.

32. Në lidhje me lokacionin e veturës Audi nga e cila është marrë gjurma e gishtit, provat si dhe aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme, është e qartë se gjurma e gishtit është marrë nga pjesa e pasme e bagazhit të veturës.<sup>17</sup>
33. Identifikimi i gjurmës së gishtit si përputhje për gishtin e mesëm të dorës së djathtë të të pandehurit është vërtetuar nga dëshmia e ekspertit dhe raporti i N. L. Mbrojtja nuk ka ngritur asnje argument bindës për ta zhvleftësuar identifikimin.
34. *Kontaminimi i vendit të krimtit.* Ankesa pretendon se që të dyja vendi i krimtit dhe lokacioni kur gjendej vetura Audi me ngjyrë të bardhë nuk janë siguruar në mënyrë të duhur, dhe për këtë arsyen janë kontaminuar. Gjykata refuzon këtë pikë pasi që është thjeshtë në pretendim i përgjithshëm pa argumente mbështetëse apo prova për të treguar saktësisht se si vendi i krimtit apo provat specifika kanë mundur të kontaminohen.
35. *Përdorimi i paautorizuar i armëve.* Ankesa pretendon se edhe nëse B. K. ka qenë vozitës i veturës Audi, ai nuk ka mundur të jetë penalish përgjegjës për akuzën Përdorim i paautorizuar i armëve sepse ai nuk ka mundur njëkohësisht të vozis veturën dhe të shtijë me armë në Policë. Mbrojtja e keqkupton mënyrën e kryerjes së veprës penale.
36. Siç është shtjelluar në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut (në faqe 38) dhe përsëri në aktgjykimin e Gjykatës Supreme (në faqet 22-23), i pandehuri nuk është dënuar për këtë akuzë në bazë të drejtimit fizik dhe shtënieve nga arma. Më parë, ka qenë pjesëmarta e të pandehurit si vozitës i veturës të përdorur për kryerjen e sulmit i cili ka shpie në përgjegjësinë e tij penale. Kur B. K. ka vozitur veturën Audi, ai e ka bërë këtë duke pasur njohuri se së paku një udhëtar në veturë

<sup>17</sup> Aktgjyki Kp nr. 412/2006, Gjykata e Qarkut në Pejë, 19 shtator 2007, f. 33-34; Aktgjyki Ap.-Kz. Nr. 153/2008, Gjykata Supreme e Kosovës, 12 janar 2010, f. 18.

ka pasur në posedim një armë dhe se kjo armë do të përdorej për të shtënë në Policë. Në të vërtetë, qëllimi i vetëm i vozitjes së tij të veturës Audi ka qenë që të kryej vrasjet e kundërligjshme të Policëve. Për më tepër, ky akt nuk ka mundur të kryhet vetëm në mënyrë të tillë, por ka kërkuar veprime të koordinuara të së paku dy personave. Prandaj, B [REDACTED] K [REDACTED] me dëshirë ka pasur armën brenda sferës së tij të ndikimit (veturës Audi) dhe ka kryer veprën Përdorim i paautorizuar i armëve në bashkëpunim me qitësin fizik.

37. *Alibi i të pandehurit.* Ankesa pretendon se dëshmitarët në mbështetje alibisë së të pandehurit nuk janë llogaritur në mënyrë të duhur nga trupi gjykues. Përsëri, gjykata patjetër duhet të përsëris se gjykata e shkallës së parë si gjykatë e faktit dhe organi i vetëm për të dëgjuar dëshmitë e drejtpërdrejta, duhet patjetër të ushtroj detyrën e vlerësimit të kredibilitetit të dëshmitarëve. Gjykata e shkallës së dytë, dhe në këtë lëndë tretë, me radhë vlerësojnë nëse ky vlerësim është bërë në mënyrë të duhur. Kjo gjykatë nuk është e bindur se vlerësimi i kredibilitetit të dëshmitarit alibi nga Gjykata e Qarkut ka qenë i gabuar dhe për këtë arsy nuk do t'i trazoj gjetjes e saj në lidhje me këtë. Analiza e Gjykatës së Qarkut sa i përket kredibilitetit të secilit dëshmitar alibi është e detajuar në akt gjykim e saj (në faqet 26-29). Përveç kësaj, Gjykata e Qarkut ka siguruar një vlerësim të hollësishëm të kredibilitetit të dëshmisë së të pandehurit në lidhje me *inter alia* alibinë e tij (në faqet 25-26).

#### Vërtetimi jo i plotë i fakteve

38. Në mbështetje të kësaj baze, ankesa ngrit refuzimin nga Gjykata e Qarkut për të dëgjuar dëshmitarët në vijim të propozuar nga mbrojtja gjatë shqyrtimit gjyqësor:

1. N [REDACTED] L [REDACTED]
2. S [REDACTED] Z [REDACTED]
3. B [REDACTED] F [REDACTED]
4. V [REDACTED] B [REDACTED]
5. I [REDACTED] B [REDACTED]
6. B [REDACTED] Be [REDACTED]

7. Policje R [REDACTED] Z [REDACTED]
8. F [REDACTED] H [REDACTED]
9. Polici G [REDACTED] K [REDACTED]
10. Polici B [REDACTED] A [REDACTED]
11. Polici M [REDACTED] B [REDACTED]

39. Të gjithë këta dëshmitarë me përjashtim të V [REDACTED] B [REDACTED], B [REDACTED] B [REDACTED] dhe F [REDACTED] H [REDACTED], janë propozuar nga avokati mbrojtës gjatë shqyrtimit gjyqësor më 03 korrik 2007, jo për të dhënë dëshmi të drejtpërdrejta por që deklaratat e tyre të mëparshme të lexohen në procesverbal. Në atë ditë, ka ndodhur shkëmbimi në vijim:

*Kryetari i trupit gjykues: Supozoj se këta dëshmitarë të cilët i keni propozuar nuk janë dëshmitarë kyçë, sepse po të ishin, ju do t'i ftonit që të dëshmojnë para gjykatës.*

*Avokati mbrojtës E [REDACTED] N [REDACTED]: Unë nuk jam në pozitë që të vendosi lidhur me këtë, pasi që këta janë dëshmitarë të Prokurorit Publik. Prokurori Publik i ka tërhequr këta dëshmitarë dhe ajo qfarë kërkoi unë është që të merren parasysh deklaratat si të lexuara në procesverbal.*

*Kryetari i trupit gjykues: Por ju nuk e konsideroni që t'i ftoni që të dëshmojnë në gjykatë.*

*E [REDACTED] N [REDACTED]: Jo.*

Si rrjedhim, avokati mbrojtës, në mënyrë të qartë, nuk pranoi të propozojë që këta persona të thirren si dëshmitarë që të marrin pjesë gjatë shqyrtimit kryesor. Si të tillë, mbrojtja tani nuk mund të ngreh si bazë të kundërt të ankesës se i është mohuar mundësia për t'i thirrur këta dëshmitarë për të dëshmuar.

40. Për më tepër, është vërejtur se avokati mbrojtës është pyetur në mënyrë të qartë nga trupi gjykues për të identifikuar se cilët persona konsiderohen si dëshmitar ‘vital’ në lëndën e tij. Mbrojtja ka renditur G [REDACTED] K [REDACTED], S [REDACTED] F [REDACTED], A [REDACTED]

H[REDACTED], V[REDACTED] H[REDACTED] dhe N[REDACTED] L[REDACTED] si thelbësor.<sup>18</sup> Deklarimet e mëhershme të të gjithë këtyre dëshmitarëve me përjashtim të G[REDACTED] K[REDACTED] janë pranuar më pas në prova.<sup>19</sup>

41. Në lidhje me V[REDACTED] B[REDACTED] dhe B[REDACTED] B[REDACTED], mbrojtja i ka propozuar këta të dy si dëshmitarë në një parashtresë me shkrim më datën 26 mars 2007, para fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Vihet re se nuk ka pasur informata të sjella në lidhje me rëndësinë e dëshmisi së tyre. Me të filluar të shqyrtimit gjyqësor, mbrojtja nuk ka propozuar as të thirren këta dëshmitarë e as të lexohen deklarimet e tyre të mëhershme në shënim. F[REDACTED] H[REDACTED] asnjëherë nuk është propozuar si dëshmitare nga mbrojtja gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe emri i saj për herë të parë shfaqet si dëshmitare e propozuar në ankesën e avokatit mbrojtës kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe më pastaj përsëri në ankesën kundër aktgjykimit të shkallës së dytë.
42. Ky kolegj vëren se nuk është në kompetencë të gjykatës së shkallës së tretë për të marrë prova të reja, pasi që është e ndaluar nga mbajtja e një shqyrtimi (Neni 430 paragrafi (2) të KPK). Sfera e saj shtrihet vetëm për të shqyrtuar nëse propozimi i dëshmitarëve të emëruar është konsideruar në mënyrë adekuate nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.
43. Në lidhje me këta tre persona, gjykata e shkallës së dytë deklaroi se natyra e saktë e kërkësës së mbrojtjes ishte jo e qartë, dhe ka vërejtur se asnjëri nga të tretë nuk është propozuar si dëshmitar i mbrojtjes gjatë shqyrtimit gjyqësor. Më tutje, gjykata deklaroi se kolegji i apelit nuk merr prova të reja gjatë seancës.<sup>20</sup>
44. Ky kolegj niset nga pikëpamja se duke e mbajtur të heshtur në gjykimin e shkallës së parë në lidhje me këta tre dëshmitarë, mbrojtja ka humbur të drejtën për t'i thirrur ata. Për më tepër, me propozimin e tyre në shkallë të

<sup>18</sup> Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor, 03 korrik 2007, p. 5.

<sup>19</sup> Aktvendimi KP nr. 412.2006, 03 korrik 2007.

<sup>20</sup> Ap.-Kz. Nr. 153/2008 n. f. 21.

dytë dhe të tretë, mbrojtja nuk ka mundur të tregojë se çfarë fakte specifike këta dëshmitarë do të dëshmojnë të cilat janë të një rëndësie të veçantë në këtë lëndë. Prandaj ankesa nuk mund të vërtetojë se ka pasur një vërtetim jo të plotë të fakteve për shkak të mungesës së dëshmive të këtyre personave.

*Shqiptim i kundërligishëm i dënimit*

45. Ankesa përmban se për shkak të 'vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë', nuk ka pasur bazë për të shpallur të pandehurin fajtor dhe prandaj as bazë për të shqiptuar dënimin. Për shkak se gjykata ka refuzuar të gjitha argumentet e ankesës me të cilat është kundërshtuar vërtetimi faktik i gjykatës së shkallës së parë dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë me të cilin i pandehuri dënohet për të gjitha akuzat, ky pohim logjikisht bie.
46. Për të gjitha arsyet e lartë përmendura, u vendos si në dispozitiv.

Api.-Kzi. nr. 02/2010  
08 qershor 2012

*Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.*

Kryetari i kolegit

Procesmbajtësja

---

Martti Harsia

---

Tara Khan

Gjyqtar i EULEX-it

Gjyqtare e Gjykatës Supreme

---

Horst Proetel

---

Nesrin Lushta

Gjyqtar i EULEX-it

Gjyqtar i Gjykatës Supreme

---

Tore Thomassen

---

Avdi Dinaj